



Pranuar / Dorezuar Prenjeno/Prodato Received/Delivered	28.12.2021	1	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKIMSHCK	6373/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.933/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.933/2021 të datës 15.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr “Uran Ajeti” , Blloku C-2 hyr.2, kati 2 nr.8, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.933 /2021 e datës 15.11.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi vendimi i Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën Shef i Inxhinierëve në Stacionin /Njësia Sektori i Inxhinieringut në Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve me kontratë pune për kohë të pacaktuar me Nr.ref.07/1-01A/0653 e datës 05.10.2016, me datën 28.10.2021, Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës me vendimin me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 i shqipton masën disiplinore “Ndalesë prej 30% të pagës mujore bruto për tre(3)muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5446/2021 për Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e vendimit të Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Policinë e Kosovës. Më datë 07.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Policia e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.11.2021 me numër protokollit 5446/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi të Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës; Vendimi për korrigjimin vendimit të Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 të Policisë së Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 26.10.2021 të Policisë së Kosovës; E-mail zyrtar i datës 19.10.2021, Pranimi teknik i përkohshëm për projektin „Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani i Elezit,, me nr. të prokurimit 214/20/036/521, i datës 13.10.2021 me nr.1349; Vendimi i datës 15.06.2021 me nr.ref.08-05-224-DMO/21; Memorandum zyrtar i datës 14.07.2021; Deklarata e inxhinierit i datës 14.09.2021; Diploma e datës 04.02.2016 me nr.1220 e lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina: Kopje e vërtetuar nga origjinali te noteri; Vendim i datës 14.09.021; Deklaratë e i datës 14.09.2021; E-mail zyrtar i datës 14.10.2021; Formular i paraqitjes së disiplinës së brendshme; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; Vendimi i Komisionit për inspektim i datës 15.06.2021 me nr.ref.08-05-224-DMO/21; Çertifikatë e inspektimit; Memorandum zyrtar ; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 13.07.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail i datës 08.09.2021; E-mail i datës 06.09.2021; E-mail i datës 03.09.2021; E-mail i datës 06.09.2021; E-mail i datës 03.09.2021; E-mail i datës 13.07.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail i datës 30.08.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 01.09.2021; E-mail zyrtar i datës 30.08.2021; E-mail i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 23.08.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 14.06.2021; E-mail zyrtar i datës 14.06.2021; E-mail zyrtar i datës 11.06.2021; E-mail zyrtar i datës 11.06.2021, E-mail zyrtar i datës 28.10.2021, E-mail zyrtar i datës 25.10.2021; E-mail zyrtar i datës 03.11.2021; E-mail zyrtar i datës 30.09.2021; E-mail zyrtar i datës 29.09.2021; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021; E-mail zyrtar i datës 20.09.2021; E-mail zyrtar i datës 14.09.2021; E-mail i datës 13.09.2021; E-mail zyrtar i datës 10.09.2021; E-mail zyrtar i datës 10.09.2021; E-mail zyrtar i datës 30.08.2021; E-mail Zyrtar i datës 13.09.2021; E-mail zyrtar i datës 23.09.2021; E-mail i datës 22.09.2021; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021; E-mail zyrtar i datës 20.09.2021; E-mil zyrtar i datës 13.09.2021; E-mail zyrtar i datës 10.09.2021; E-mail zyrtar i datës i datës 21.09.2021, E-mail zyrtar i datës 20.09.2021; E-mail zyrtar i datës 14.09.2021; E-mail zyrtar i datës 13.10.2021; E-mail zyrtar i datës 13.09.2021; E-mail zyrtar i

datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 01.09.2021; E-mail zyrtar i datës 30.09.2021; E-mail zyrtar i datës 29.09.2021; E-mail zyrtar i datës 14.09.2021; E-mail zyrtar i datës i datës 13.09.2021; E-mail zyrtar i datës 15.10.2021; E-mail zyrtar i datës 22.09.2021; E-mail zyrtar i datës 10.09.2021; Kontratë pune për kohë të pacaktuar me nr.ref.07/1-01A/0653 e datës 05.10.2016 për në pozitën Shef i Inxhinierëve, në Stacionin /Njësia Sektori inxhinieringu në Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 13.07.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; E-mail zyrtar i datës 13.07.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; Urdhëresë e datës 17.11.2021 për ekzekutimin e vendimit; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 26.10.2021; Shpallja e vendimit të Komisionit Disiplinor i datës 26.10.2021; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 19.10.2021; E-mail zyrtar i datës 25.10.2021. Raporti i Komisionit për inspektim, Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani i Elezit i datës 24.06.2021; Shkresat njoftuese për përmirësimin e vërejtjeve(faqe 96), E-mail zyrtar i datës 02.07.2021; Shkresa nr.3 (faqe 98), E-mail zyrtar i datës 14.07.2021; E-mail zyrtar i datës 09.03.2021; E-mail zyrtar i datës 28.04.2021; E-mail Zyrtar i datës 11.05.2021; Vazhdimi i mbulesës në PKK Hani i Elezit në vlerë 13.406.75 Euro; E-mail i datës 13.07.2021(faqe 111); E-mail zyrtar i datës 13.07.2021; E-mail i datës 14.07.2021; E-mail zyrtar i datës 15.07.2021; E-mail zyrtar i datës 14.07.2021(117); E-mail zyrtar i datës 13.07.2021 dhe Përgjigje në ankesë e datës 07.12.2021 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/124.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Blerim Mustafaj, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 i Policisë së Kosovës me të cilin i shqiptohet masa disiplinore, Ndalesë prej 30% të pagës mujore bruto për tre(3)muaj, është në kundërshtim me nenin 45, 46,47 dhe neni 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës me nr. KDNSHC-05/047.2021 të datës 28.10.2021 është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Ankuesi z.

me datën 20.09.2021 kishte iniciuar procedurë disiplinore ndaj tre anëtarëve të komisionit për inspektim të themeluar me vendimin me nr.ref: 08-05-224-DMO/21 të datës 15.06.2021 për kontratën "Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani Elezit" me nr. prokurimi 214/20/036/521. Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 19.10.2021, në seancë është intervistuar edhe Blerim Mustafaj i cili me datën 20.09.2021 ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj komisionit për inspektim i themeluar me vendimin e datës 15.06.2021 me nr.ref.08-05-224-DMO/21 për inspektimin e kontratës "Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani i Elezit" me nr. të prokurimit 214/20/036/521" të cilin e ka themeluar Drejtori i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve.

Ankuesi në seancën dëgjimore ka deklaruar se : ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj komisionit për inspektim me arsyetimin se inspektimi për projektin "Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani i Elezit .. me nr. të prokurimit 214/20/036/521" komisioni nuk ka pas koordinim ashtu siç

duhet. Me datën 04.08.2021 kam kërkuar nga komisioni që të dalin në inspektim dhe të përpilojnë certifikatën e inspektimit e cila nënshkruhet nga tre anëtarët e komisionit, edhe pse ankuesi e ka pranuar se nuk është kompetencë e tij, por sipas ankuesit jam munduar që të funksionojë puna më mirë, mirëpo në vazhdimësi kemi bërë edhe një gabim sepse është formuar një komision tjetër pa e shfuqizuar vendimin e komisionit paraprak, Ndër të tjera i përmend edhe dy certifikata të cilat ja ka dërguar kryetari të komisionit për inspektim që kanë qenë të nënshkruara: njëra prej dy anëtarëve e tjetra prej një anëtari dhe kryetari të komisionit të cilat certifikata nuk i ka pranuar kryetari i komisionit për inspektim pasi që nuk janë të nënshkruara nga tre anëtarët e komisionit.

Kompletimi i lëndës për pagesë është bërë në bazë të raportit të komisionit të jashtëm nga DSPIMNQ-MAP/MPB për inspektim të punëve të realizuara në bazë të kontratës “Vazhdimi i mbulohës në PKK Hani i Elezit., me nr. të prokurimit 214/20/036/521”, së bashku me dy raportet e komisionit të themeluar nga Major Sylejmani/Drejtor i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve me vendimin me nr.ref: 08-05-224-DMO/21 të datës 15.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit se përpilimin e raportit apo certifikatën ligjërisht duhet ta bëjë vetëm kryetari i komisionit për inspektim, në bazë të provave që ka poseduar nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi që raportin dhe certifikatën janë përpiluar nga anëtarja e komisionit znj. –Inxhinierë e Ndërtimitarisë dhe nuk kishte pasur asnjë kundërshtim. Po ashtu komisioni disiplinor ka vërtetuar se certifikata e inspektimit final e përpiluar nga kryetari i komisionit për inspektim nuk i është vendosur data e inspektimit të realizuar, data e përpilimit dhe data kur është nënshkruar nga anëtarët e komisionit, ndërsa z. me shkresë elektronike të datës 28.09.2021 ka deklaruar se; “vlerësoj se ky raport është valid dhe mund të procedohet për pagesë”, ndërsa komisioni disiplinor vërteton se komisioni i jashtëm nga DSPIMNQ-MAP/MPB për inspektim të punëve të realizuara në bazë të kontratës “Vazhdimi i mbulohës në PKK Hani i Elezit., me nr. të prokurimit 214/20/036/521” nuk e ka kontestuar raportin e përpiluar nga anëtarja e komisionit znj. –Inxhinierë e Ndërtimitarisë, i cili raport është marrë për bazë në hartimin e raportit final nga ky komision.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se komisioni disiplinor ka vërtetuar se certifikata e inspektimit final nga kryetari i komisionit inspektues edhe pse nuk ka qenë e vendosur as data e përpilimit as data e nënshkrimit nga anëtarët e komisionit, nuk e ka kontestuar këtë raport, përkundrazi ka insistuar që anëtarëve të komisionit të ju shqiptoj vërejtje përmes shkresës elektronike të datës 08.09.2021 në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj komisioni disiplinor ka vërtetuar se i njëjti ka tejkuluar kompetencat të cilën e pranon në deklaratën e dhënë në seancën dëgjimore se komisioni i themeluar nga Drejtori i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve me vendimin me nr.ref: 08-05-224-DMO/21 të datës 15.06.2021 i përgjigjet organit që e ka themeluar.

Mbi bazën e fakteve dhe deklaratës në seancë dëgjimore të Komisionit Disiplinor, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se z. në pozitën e shefit të sektorit të inxhinieringut ka tejkuluar kompetencat në raport me komisionin inspektues të themeluar nga Drejtori i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve me vendimin me nr.ref: 08-05-224-DMO/21 të datës 15.06.2021, andaj Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.10 dhe nenit 47

paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se :” 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi” dhe 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”, dhe nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se “3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri te 3.11 të Ligjit”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi i Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 i datës 28.10.2021 i Policisë së Kosovës është nxjerrë në pajtim me dispozitat e nenit 46, 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.933/2021, datë 28.12.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.